

## **Eficienca e energjisë në Shqipëri, baza ligjore dhe objektivat**

Zbatimi i direktivës për eficientësi të energjisë Një version i rishikuar i Ligjit për Eficencën e Energjisë (Republika e Shqipërisë 2014a) është përgatitur në linjë me Direktivën 2012/27/EC. Projekt ligji përcakton kuadrin për:

- vendosjen e objektivave të kursimit të energjisë deri në 2020;
- hartimin e PIKEVE çdo tre vjet, duke bërë një analizë të realizimit të PKVEE së planit të mëparshëm dhe dhënë strategjinë për arritjen e objektivave përfundimtarë dhe të ndërmjetëm;
- monitorimin e zbatimit të PKVEE përmes një agencie të veçantë;
- vendosjen e matësive individuale për përdoruesit fundorë, përmes një agencie përgjegjëse;
- ngritjen e ndërgjegjësimit të përdoruesve dhe pronarëve të banesave dhe kualifikimit të nënpunësve civilë përmes një agencie;
- kërkesat minimale të performancës së energjisë për ndërtesat e reja ose për ato që do të kenë rikonstrukcion tërësor, si dhe për elementët e ndërtimit;
- kërkesat minimale të performancës së energjisë për sistemet teknike të ndërtimit;
- inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe të ajrit të kondicionuar;
- kërkesat minimale të performancës së energjisë për produktet që përdorin energji;
- Auditet e energjisë për zbatuesit e programeve të financuara nga Fondi i Eficencës së Energjisë;
- dhënie të shërbimeve të energjisë prej kompanive të shërbimeve të energjisë (ESCOs);
- ngritjen dhe financimin e Fondit të Eficencës së Energjisë;
- ngritjen e një agencie përgjegjëse për eficientësi të energjisë;

dhe marrjen e të dhënave lidhur me konsumatorin në kohë reale dhe për ato të shkuara, lidhur me konsumin e energjisë me anë të matësive individuale, miratuar me Ligjin 68/2012 për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji. Zbatimi i akteve nënligjore për eficientësi të energjisë është ende në proces përgatitjeje.

### **Baza ligjore**

Ligji Nr. 124/2015, datë 11/11/2015 “Për eficientësi të energjisë”;

Ligji Nr. 116/2016, datë 10/11/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”;

VKM Nr. 709, datë 1/12/2017 “Për miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficencën e Energjisë për Shqipërinë”;

Vendim 407, datë 19/06/2012 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”;

Vendim 537, datë 08/07/2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave”;

EN 16247 2 , Maj 2014, Normativa Europiane, Ndërtesat;

EN 16247 3, Maj 2014, Normativa Europiane, Proceset;

EN 16247 4, Maj 2014, Normativa Europiane, Transporti;

EN 16247 5 , Maj 2015, Normativa Europiane, Kompetencat e audituesve të energjisë.

### **Financimi i eficiencës së energjisë**

Pavarësisht planeve të qeverisë për të mbështetur me financime eficiencën e energjisë, deri më tani nuk ka ndonjë linjë buxhetore për këtë qëllim dhe kjo gjë nuk është planifikuar as në PKVEE e parë (Sekretariati i Kartës së Energjisë 2013). Islami (2013) ka përgatitur në studim të plotë e bashkëkohor për financimin e eficiencës së energjisë të dhëna prej institucioneve financiare ndërkombëtare dhe bankave tregtare në Shqipëri. Autori ka përcaktuar disa produkte kredie që janë në tregun shqiptar për eficiencën e energjisë në sektorin e ndërtesave të banimit:

- Huadhënësi kryesor: Banka ProCredit;
- IFC përmes bankave partnere të mëdha: Banka Credins, Societe Generale;
- IFC përmes institucioneve financiare më të vogla: Fondi BESA, NOA Financojmë

Përveç këtyre produkteve kredie të specializuar në eficiencën e energjisë (psh. Banka Raiffeisen, Banka Intesa Sanpaolo, NBG). Këto kredi nuk e kanë si objektiv specifik eficiencën e energjisë, por mund të përdoren për këtë qëllim.

### **Referenca**

Hensel, M. Improving energy efficiency in buildings.BASE.

Islami, G., & Veizaj, D. (2014). Comfort Conditions and Energy Consumption in Prefabricated Houses in Tirana. 2nd ICAUD International Conference in Architecture and Urban Design. Tiranë.

SLED "Tipologjia e stokut të ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe modeli i shndërrimit të tyre për shkarkime të ulta karboni në të ardhmen. Mbështetje për zhvillimet me shkarkime të ulëta karboni në Evropën JugLindore".

Dorri, A. Bazat e Auditimit Energjistik, ICT